



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 3, datë 22.01.2020

PËR

**DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN NR. 139, DATË, 26.09.2012 “PËR
PËRLLOGARITJEN E VLERËS NETO TË ASETETEVE TË FONDIT TË PENSIONIT
VULLNETAR DHE AFATET E PUBLIKIMIT TË INFORMACIONIT”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 2 të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e disa ndryshimeve në Rregulloren nr. 139, datë 26.09.2012 “Për përllogaritjen e vlerës neto të asetëve të fondit të pensionit vullnetar dhe afatet e publikimit të informacionit”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Kapitaleve dhe Fondeve, për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Ervin METE

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Ervin KOÇI

Në Rregulloren nr. 139, datë, 26.09.2012 “Për përlogaritjen e vlerës neto të aseteve të fondit të pensionit vullnetar dhe afatet e publikimit të informacionit”, e ndryshuar, bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Në nenin 18, bëhen këto ndryshime:

- Në pikën 1, shtohet fjalia si vijon:

“Forma dhe përmbajtja e këtij informacioni janë përcaktuar në Tabelën nr. 1, Shtojca 1, që është pjesë integrale e kësaj rregulloreje.”

- Në pikën 2, togfjalëshi “brenda datës 3 të muajit pasardhës” të zëvendësohet me togfjalëshin “brenda 3 ditë pune të muajit pasardhës”.

- Pas pikës 2, shtohet pika 3 me përmbajtje si vijon:

“3. Depozitari raporton në Autoritet mbi portofolin e investimeve të aseteve të fondit të pensionit, për vlerën nominale dhe kontabël të këtyre aseteve si dhe për datën e maturimit të instrumentave financiarë që përbëjnë portofolin e investimeve. Forma dhe përmbajtja e këtij informacioni janë përcaktuar në Tabelën nr. 2, Shtojca 1, që është pjesë integrale e kësaj rregulloreje.”

- Pika 3, renditet si pika 6, me përmbajtje të pandryshuar.

- Shtohet pika 4, me përmbajtje si vijon:

“4. Depozitari raporton në Autoritet brenda datës 15 të muajit pasardhës, pas përfundimit të çdo tremujori të vitit, të dhënat mbi portofolin e investimeve sipas paragrafit 3 të këtij neni.”

- Shtohet pika 5, me përmbajtje si vijon:

“5. Të dhënat e përcaktuara në paragrafin 1 dhe 3 të këtij neni duhen të paraqiten në formë shkresore pranë Autoritetit si dhe në formë elektronike nëpërmjet sistemit pranë linkut vënë në dispozicion në faqen e Autoritetit.”

2. Shtohet Shtojca 1, që përmban Tabelat nr. 1 dhe nr. 2 si më poshtë:

Shtojca 1

Tabela nr. 1

Informacioni mujor			
Data	Vlera neto e aseteve të fondit të pensionit (NAV)	Numri i kuotave të fondit të pensionit	Çmimi i kuotës i fondit të pensionit (NAV/Kuotë)

Tabela nr. 2

Portofoli i investimeve të fondit të pensionit					
Instrumenti	ISIN	Vlera nominale	Vlera kontabël	Monedha	Data e maturimit